



SEKRETET TREGTARE TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE:

Paradokset e praktikës në Mal të Zi



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancohet nga Ministria e Administratës Publike.



Ministarstvo javne uprave

Titulli i publikimit:

**Sekretet tregtare të ndërmarrjeve publike:
Paradokset e praktikës në Mal të Zi**

Botues:

Instituti Alternativa

Bulevardi Xhorxh Vashington 57, Podgoricë, Mali i Zi

Tel/fax: **+382 (0) 20 268 686**

E-mail: **info@institut-alternativa.org**

Për botuesin:

Stevo Muk

Redaktor:

Stevo Muk

Autore:

Marko Soshiq, Milena Muk

Përkthyes:

Ardita Rama

Faqosja dhe dizajni:

Ana Jovoviq

Podgoricë, qershor 2019



Ministarstvo javne uprave

Kjo analizë është realizuar në kuadër të projektit "Money Watch: Shoqëria Civile, Kujdestare e Buxhetit", të cilin e realizon Instituti Alternativa në bashkëpunim me Institutin për Financat Publike dhe OJQ Horizonti i Ri, me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe bashkëfinancim nga Ministria e Administratës Publike.

Përmbajtja e raportit është përgjegjësi e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe Ministrisë së Administratës Publike.

PËRMBAJTJA

Hyrje	4
Sekret tregtar është ajo që "shpallet sekret tregtar"	5
Kur është interesi publik mbi sekretin tregtar?	8
Standardet e OECD për ndërmarrjet në pronësi shtetërore	9
Praktika aq "e mirë" sa edhe ligji	9
Si më tej?	11
Rekomandime:	13
BURIMET:	15
Shtojcë 1: Standardizimi i sekretit tregtar në ligje të veçanta	16

HYRJE

Në vitin 2017, në Ligjin e Malit të Zi për Qasjen e Lirë në Informata u fut koncepti i sekretit tregtar dhe tatimor si bazë për të kufizuar qasjen në informata. Sipas nenit 14 të këtij Ligji, organi i pushtetit mund të kufizojë qasjen në informatë ose në një pjesë të informatës, ndër të tjera, nëse informata është sekret tregtar ose tatimor në përputhje me ligjin. Për dallim nga arsyet e tjera për kufizimin e qasjes në informata¹, Ligji nuk ka përcaktuar afat kohor për kufizimin e qasjes në informata mbi këtë bazë. Gjithashtu, megjithëse dispozita i referohet ligjeve specifike («në përputhje me ligjin»), nuk ekziston asnjë definicion i njësuar i sekretit tregtar në legjislacionin e Malit të Zi, çka lë vend për abuzim të këtij instituti.

Konfuzion shtesë në këtë fushë shton fakti se sekreti tregtar përmendet në një vend tjetër në të njëjtin nen të Ligjit për Qasje të Lirë në Informata. Konkretisht, neni 14, paragrafi 5, thotë edhe se qasja në informatë ose në një pjesë të informatës mund të kufizohet për shkak të «mbrojtjes së interesave tregtare dhe interesave të tjera ekonomike nga publikimi i të dhënave të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e konkurrencës si dhe me sekretin tregtar në lidhje me të drejtën e pronësisë intelektuale». **Imponohet dallimi midis konceptit të sekretit tregtar në lidhje me mbrojtjen e të drejtës së pronësisë intelektuale nga «sekretet e tjera tregtare», me ç'rast ky dallim nuk është shpjeguar sa duhet.**

Instituti Alternativa në analizën e tij «Reforma e financave publike dhe sekreti tatimor: Përmes prizmit të borxhit të komunave» përshkroi se si futja e «sekretit tatimor» dëmtoi transparencën e financave publike². Duke pasur parasysh rëndësinë e inicimit të një debati për këto çështje, këtë analizë ia kushtuam një fushe tjetër, në të cilën ndërthuren interesi komercial dhe publik, me shumë paqartësi, interpretime të ndryshme të normave juridike, ngushtim të pajustificuar të së drejtës së qytetarëve për të ditur se si menaxhohen paratë publike: standardizimit të sekretit tregtar nga ndërmarrjet, te të cilat pronar i shumicës së aksioneve është shteti.

Me Programin e Punës së Qeverisë për vitin 2019 parashihen ndryshime në Ligjin për Qasje të Lirë në Informata. Duke pasur parasysh që është në përpilim e sipër Ligji i ri, e kemi për qëllim që me këtë analizë të demonstrojmë pabazueshmërinë e normës juridike e cila i referohet sekretit tregtar dhe «konfuzionin» që ai prodhon në praktikë, gjë që në përgjithësi «e paguajnë» qytetarët me pamundësinë për të pasur informata themelore, të cilat do të duhej ta përmirësonin dhënien e llogarisë nga pushteti dhe me këtë edhe përgjegjësinë e menaxhimit të financave publike.

Në përpjekje për të hedhur dritë mbi këtë çështje, ne jemi përqendruar në ndërmarrjet që janë në pronë të shtetit, të cilat mbeten një zonë e lënë pas dore e menaxhimit të financave

1/ Mbrojtja e privatësisë; siguria e mbrojtjes, politikës së jashtme, monetare dhe ekonomike të Malit të Zi; parandalimi i hetimit dhe ndjekjes penale të autorëve të veprave penale; kryerja e detyrës zyrtare; mbrojtja e interesave tregtare dhe ekonomike

2/ <https://institut-alternativa.org/reforma-javnih-finansija-i-poreska-tajna-kroz-prizmu-opstinskog-duga/>

publike, pavarësisht se kanë një pjesë të konsiderueshme në shpenzimet publike dhe ekonominë në përgjithësi. Megjithatë nuk ka të dhëna të përgjithshme zyrtare për numrin e ndërmarrjeve publike në Mal të Zi, në vitin 2015, IA numëroi 37 ndërmarrje, të cilat shteti zotëron shumicën e aksioneve, ndërsa sipas të dhënave më të fundit të vitit 2019 nga Ministria e Financave, ekzistojnë vetëm 32³. Vetëm 21 ndërmarrje, për të cilat janë në dispozicion të dhënat në portalin e Administratës Tatimore, në vitin 2018 punësuan 5 286 persona, për të ardhurat e të cilëve u shpenzuan mbi 70 milion euro. Pothuajse gjysma e këtyre ndërmarrjeve (nëntë prej tyre) vitin e kaluar kanë punuar me humbje, të cilat gjithsej janë mbi 8 milion €.

Me qëllim që të hedhim dritë në çështjen se kujt krejt i referohen sekretet tregtare të ndërmarrjeve publike, ne së pari mbledhëm dokumente të disponueshme publikisht (statutet e ndërmarrjeve, rregulloret për sekretin tregtar) dhe dërguam 24 kërkesa shtesë për qasje të lirë në informata, në mënyrë që të njihemi me vendimet e këshilleve drejtuese ose akte të tjera interne, me të cilat standardizohet menaxhimi i sekreteve tregtare në këto ndërmarrje e që nuk janë në dispozicion publik. Në pjesën e parë japim një pasqyrë të kategorive të informatave që më së shpeshti quhen sekrete tregtare nga ndërmarrjet “publike” në Mal të Zi, në pjesën e dytë analizojmë të dhënat e mbledhura në dritën e standardeve ndërkombëtare. Në fund, cekim nevojën për një standardizim më të saktë të sekretit tregtar në sistemin juridik të Malit të Zi, por edhe për një përshkrim të detajuar të përjashtimeve - kategorive të informatave, të cilat nuk guxojnë të deklarohen sekret tregtar nga ndërmarrjet me pronësi të shumicës së aksioneve shtetërore dhe të qeverisjeve vendore.

SEKRET TREGTAR ËSHTË AJO QË “SHPALLET SEKRET TREGTAR”

Mali i Zi nuk ka një ligj të veçantë që rregullon në mënyrë sistematike çështjen e sekretit tregtar, por ligje të ndryshme (Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës, Ligji për Shoqëritë Tregtare, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji për Prokurimet Publike, Ligji për Statistikat Zyrtare, Ligji për Shërbimin Doganor, Ligji për Bankat, Ligji për Mbrojtjen e Informatave të Papublikuara, Kodi Penal...) në disa vende indirekt fusin konceptin e sekretit tregtar, duke u përshkruar autoriteteve kontraktuese të prokurimeve publike, përfaqësuesve, auditorëve ose punonjësve detyrimin e mbajtjes së sekretit tregtar ose informatave konfidenciale e të ngjashme, por më shpesh pa një përcaktim më të afërt të asaj që nënkuptojnë.

Pra, shoqëritë tregtare, përfshirë ato, pronar i shumicës së aksioneve të cilave është shteti, **nuk kanë një bazë të saktë ligjore për përcaktimin e dokumenteve dhe të dhënave të cilat mund të konsiderohen sekrete tregtare.** Në praktikë, ato në parim më së shpeshti i përcaktojnë këto çështje me statut, ndërsa më në detaje me vendime specifike të organeve drejtuese ose duke miratuar rregullore të veçanta për sekretin tregtar.

3 / Të dhënat e dorëzuara IA nga Ministria e Financave, 24.6.2019

Duke kërkuar në internet dhe përmes kërkesave për qasje të lirë në informata, kemi ardhur deri te dokumentet e shtatëmbëdhjetë ndërmarrjeve (statutet, kodet e etikës, rregulloret e sekretit tregtar), të cilat shteti zotëron shumicën e aksioneve, të cilat përcaktojnë sekretet tregtare në pronësi të tyre⁴, ndërsa katër ndërmarrje u përgjigjën se nuk kishin një dokument me të cilin përcaktohen sekretet tregtare.⁵ Duke analizuar këto dokumente, u vërtetua se, përveç një numri të vogël të të dhënave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e inovacioneve dhe shpikjeve të mundshme, ose proceseve në zhvillim⁶, këto akte shpesh përmbajnë formulime shumë të gjëra nga të cilat del se sekreti tregtar mund të jetë gjithçka, ose me sekrete tregtare deklarohen informatat të cilat do të duhej të jenë në dispozicion të publikut, në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë në Informata.

Të dhënat, të cilat nuk do të guxonin të mbahen sekrete dhe të njihen si të tilla nga ndërmarrjet publike përfshijnë, në mes tjerash:

- **të dhënat për pagat** - vendimet për rritjen mujore të pagave të punonjësve, vendimet për rritjen vjetore të pagave (Ndërmarrja Publike për Menaxhimin e të Mirave Detare të Malit të Zi); të dhënat për pagat dhe të ardhurat e tjera të të punësuarve (Posta e Malit të Zi SHA Podgoricë, Porti i Tivarit SHA Tivar, Mirëmbajtja e Mjeteve Hekurudhore, N.H.T. Riviera e Ulqinit Ulqin, Plantacionet "13 Korriku" SHA Podgoricë);
- **punën e organeve drejtuese** - NP Të Mirat Detare, për shembull, i deklaroi paraprakisht sekrete tregtare të gjitha informatat mbi punën dhe vendimmarrjen e Këshillit Drejtues deri në miratimin e vendimit, "Monteput" SHPK Podgoricë të gjitha materialet nga mbledhja e Bordit të Drejtorëve, procesverbalet dhe vendimet nga mbledhjet, aktet me të cilat përcaktohen strategjia dhe politika tregtare; ndërsa Porti i Tivarit të gjitha të dhënat mbi punën dhe vendimmarrjen e organeve kolektive; ndërmarrja «Plantacionet 13 Korriku SHA Podgoricë» gjithashtu i deklaroi sekret tregtar procesverbalet dhe vendimet nga mbledhjet e Bordit të Drejtorëve,
- **kontratat** – "Monteput" SHPK me Rregulloren mbi Sekretin Tregtar përfshiu kontratat për shitjen dhe fitimin e pasurisë, "Barska Plovidba" SHA Tivar të dhënat nga kontrata për qira, N.H.T. Riviera e Ulqinit Ulqinit elementet e kontratës për bashkëpunimin tekniko-tregtar; ndërsa Plantacionet "13 Korriku" SHA Podgoricë kontratat e shitblerjes,

4 / NP Parqet Nacionale të Malit të Zi, NP Ujësjellësi Rajonal Bregdeti i Malit të Zi, NP për Menaxhimin e të Mirave Detare të Malit të Zi, Elektroekonomia e Malit të Zi SHA Nikshiq, Monteput SHPK Podgoricë, Porti i Tivarit SHA Tivar, N.H.T. Riviera e Ulqinit Ulqin, Instituti i Metalurgjisë së Zezë SHA Nikshiq, "Barska plovidba" SHA Tivar, SHPK Qendra për Testime Ekotoksikologjike, Sistemi i Transmisionit Elektrik i Malit të Zi, Posta e Malit të Zi SHA Podgoricë, Mirëmbajtja e Mjeteve Hekurudhore, SHPK Operatori i Tregut Elektrik të Malit të Zi, Montenegro Bonus SHPK Cetinë, Infrastruktura Hekurudhore e Malit të Zi SHA Podgoricë, Plantacionet "13 Korriku" SHA Podgoricë

5 / Instituti "Dr Simo Millosheviq" SHA Igallo, Castello Montenegro SHA Plevle, Qendra Radio-difuzive SHPK Podgoricë dhe Porti i Kotorit SHA Kotor

6 / Për shembull, Elektroekonomia e Malit të Zi me Kod Etik i shpall inovacionet dhe patentat e saj sekret tregtar, ndërsa Posta e Malit të Zi SHA Podgoricë të dhënat për shpikje dhe përmirësime teknike

- **projektet kapitale dhe zhvillimore me rëndësi për qytetarët** - "Monteput" SHPK, ndërmarrja që administron projektin e ndërtimit të autostradës Tivar- Boljare, i ka deklaruar sekret tregtar informatat për projektet kapitale, ndërsa Sistemi i Transmetimit të Energjisë i Malit të Zi edhe të dhënat që lidhen me realizimin e projektit të ndërtimit të lidhjes nënujore me Italinë.

Deklarimi i këtyre kategorive të të dhënave si sekrete tregtare është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Ligjin për Qasje të Lirë në Informata, tatimpagues të të cilit janë edhe shoqatat tregtare "themelues, bashkëthemelues ose pronar i shumicës aksionare të të cilave është shteti". Për më tepër, i njëjti ligj përcakton detyrimet e publikimit proaktiv të mu atyre grupeve të të dhënave, të cilat deklarohen të fshehta nga ndërmarrjet më të rëndësishme publike të Malit të Zi, përfshirë kontratat për përdorimin e mjeteve financiare nga të ardhurat publike dhe të pronave shtetërore, listat e funksionarëve publikë me bilancin e pagave të tyre, draftet, propozimet dhe tekstet përfundimtare të planeve, programeve dhe dokumenteve strategjike⁷. Me fjalë të tjera, megjithëse asnjë ligj nuk e ka përcaktuar se çfarë mund të jetë sekret tregtar, ligji e ka përcaktuar atë që duhet të publikohet në mënyrë proaktive.

Organet kompetente, Ministria e Administratës Publike dhe Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasjen e Lirë në Informata, nuk kanë kontrolluar sistematikisht respektimin e detyrimeve të publikimit proaktiv të informatave nga ndërmarrjet publike. Sipas analizës së sajteve të 33 ndërmarrjeve publike në Mal të Zi, të bërë nga Rrjeti për Afirmimin e Sektorit Joqeveritar në bashkëpunim me organizatën eksperte Access Info Europe nga Madridi gjatë vitit 2018, asnjë nga ndërmarrjet e analizuara nuk publikon në mënyrë proaktive të gjitha kategoritë e informatave në mënyrën e përcaktuar me Ligj. U vërtetua se vetëm dy ndërmarrje publike publikojnë pak më shumë se gjysmën e informatave të parashikuara nga Ligji për Qasje të Lirë në Informata, ndërsa nëntë kompani nuk kanë asnjë nga këto informata në prezantimet e tyre.⁸

Sidoqoftë, ajo që është posaçërisht shqetësuese është se, përveç deklarimit për sekrete tregtare të kategorive konkrete, të cilat do të duhej të publikoheshin në mënyrë proaktive, shumica e dokumenteve të analizuara të ndërmarrjeve publike përmbajnë formulime të pasakta që praktikisht parandalojnë çdo formë të kontrollit paraprak dhe të mëvonshëm të vendimmarrjes. Në këtë drejtim, më ilustrativet janë shembujt e Portit të Tivarit, i cili me Rregulloren për Sekret Tregtar deklaron dokumentet dhe të dhënat të cilat Bordi i Drejtorëve i deklaron sekret tregtar, e Ndërmarrjes Publike për Menaxhimin e të Mirave Detare, i cila me rregullore interne për sekret tregtar përfshin edhe të gjitha informatat "të cilat janë të përcaktuara si të tilla me akt të drejtorit", e Institutit të Metalurgjisë së Zezë SHA Nikshiq ("të dhënat të cilat organet kompetente i deklarojnë sekrete"), e SHPK Qendrës për Testim

7 / Ligji për Qasje të Lirë në Informata ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 044/12 datë 09.08.2012, 030/17 datë 09.05.2017)

8 / Rrjeti për Afirmimin e Sektorit Joqeveritar, Shumica e ndërmarrjeve publike në Mal të Zi nuk publikon në mënyrë proaktive as gjysmën e informatave, 19.11.2018, në dispozicion në: <http://www.mans.co.me/vecina-javni-h-preduzeca-u-crnoj-gori-proaktivno-ne-objavljuje-ni-polovinu-informacija/> (qasja 17. 4. 2019)

Ekotoksikologjik ("dokumentet të cilat organet e Qendrës i deklarojnë sekret tregtar") dhe e SHPK Operatori i Tregut të Energjisë Elektrike në Mal të Zi (të dhënat, me zbulimin e të cilave personave të paautorizuar, mund të shkaktonin dëme për funksionimin e ndërmarrjes).

KUR ËSHTË INTERESI PUBLIK MBI SEKRETIN TREGTAR?

Ligji për Qasje të Lirë në Informata njeh institutin e interesit mbizotërues publik, i cili nënkupton detyrimin e publikimit të informatave, nëse ato tregojnë në mënyrë të arsyeshme korrupsionin, mosrespektimin e dispozitave, përdorimin e paligjshëm të fondeve publike ose keqpërdorimin e autorizimit në ushtrimin e detyrës publike; dyshimin se është kryer një vepër penale ose ekzistimin e arsyes për kundërshtimin e vendimit gjyqësor; marrjen ose shpenzimin e paligjshëm të fondeve nga të ardhurat publike; rrezikimin e sigurisë publike; rrezikimin e jetës; rrezikimin e shëndetit publik; rrezikimin e mjedisit jetësor. Para se të refuzohet qasja në një informatë të caktuar me arsyetimin se bëhet fjalë për sekret tregtar është i detyrueshëm të bëhet testi i dëmshmërisë. Mirëpo, aktet e brendshme të ndërmarrjeve publike, të formuluar siç përshkruhen më lart, praktikisht parandalojnë vlerësimin e kërcënimit të interesit publik, po edhe janë në kundërshtim me thelbin e "testit të dëmshmërisë", i cili duhet të përcaktojë në çdo rast konkret nëse është e drejtë e publikut për të ditur mbi nevojën e ndërmarrjeve publike që të emërojnë diçka si sekret tregtar. Në favor të kësaj flet fakti se nuk ekziston asnjë akt i vetëm, me të cilin sekreti tregtar do të definohej në raport me kriteret dhe elementet e tij thelbësore, të cilat gjithashtu kushtëzuan edhe «anarkinë» e rregullimit të një sekretit tregtar me akte të forcës më të ulët juridike (rregullore, vendime etj.).

Në vitin 2016, Bashkimi Evropian miratoi një Direktivë të veçantë për Mbrojtjen e Njohurive dhe Përvojave të Pazbuluara, si dhe të informatave tregtare (sekretit tregtar) nga prokurimi, përdorimi dhe zbulimi i paligjshëm⁹. Vetë emri i Direktivës i referohet përmbajtjes së termit «sekret tregtar» në kontekstin e BE-së, ndërsa në dokument sqarohet më tej se ajo i referohet kryesisht mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale, siç janë patentat, të drejtat në dizajn ose të drejtat e autorit, gjegjësisht mbrojtjes së qasjes në njohuri që kanë vlerë komerciale për subjektin, e që nuk janë të njohura përgjithësisht. Një nga arsyet kryesore për miratimin e Direktivës ishte ajo që ndërmarrjet inovative gjithnjë e më shumë i ekspozohen praktikave të padrejta me qëllim të prokurimit jashtëligjor të sekreteve tregtare, që nënkupton se ato kryesisht i referohen ndërmarrjeve inovative komerciale që veprojnë në kushte konkurruese të tregut, gjë që nuk mund të thuhet për shumicën e ndërmarrjeve shtetërore në Mal të Zi, në të cilat shteti zotëron shumicën e aksioneve, një numër i konsiderueshëm i të cilave operojnë me humbje dhe mjetet kryesisht i shpenzojnë në kushtet themelore të biznesit - të ardhurat e punonjësve e jo në inovacione. Më tej është shënuar saktë se Direktiva nuk do të duhej të

9 / Direktiva (BE) 2016/943 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian nga 8 qershori 2016 për Mbrojtjen e Njohurive dhe Përvojave të Pazbuluara, si dhe të informatave tregtare (sekretit tregtar) nga prokurimi, përdorimi dhe zbulimi i paligjshëm, Fletorja zyrtare e Bashkimit Evropian, në dispozicion në:

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/HR/TXT/?uri=CELEX%3A32016L0943> (qasja 26. 5. 2019)

ndikojë në zbatimin e rregullave shtetërore që kërkojnë zbulimin e informatave, përfshirë sekretet tregtare, për publikun. Me fjalë të tjera, Direktiva nuk do të duhej të dëmtojë të drejtën e qasjes në informata me rëndësi publike dhe të detyrimit të transparencës së organeve të pushtetit, çka është sqaruar më saktësisht në artikullin e parë të këtij dokumenti.¹⁰

STANDARDET E OECD PËR NDËRMARRJET NË PRONËSI SHTETËRORE

Në prizmin e standardeve ndërkombëtare të transparencës për ndërmarrjet në pronësi të shtetit, udhëzimet e hartuara nga OECD në vitin 2015 gjithashtu ofrojnë një kornizë të mirë për vlerësimin e praktikës në Mal të Zi¹¹. Përkatësisht, përveç faktit se kuptimi i sekretit tregtar nga ndërmarrjet publike në Mal të Zi është në kurriz të Ligjit për Qasje të Lirë në Informata, ai gjithashtu minon edhe standardet e pranuar përgjithësisht të transparencës.

Lista e detyrimeve të përcaktuara nga OECD është e gjatë dhe nisët nga nevoja që ndërmarrjet në pronësi shtetërore t'i përmbahen praktikës së publikimit të informatave financiare dhe jofinanciare të biznesit, veçanërisht në fushat me interes të përgjithshëm publik dhe në raport me ofrimin e shërbimeve publike. Ndër të tjera, këto informata do të duhej të përfshijnë rezultatet financiare dhe operacionale, me një pasqyrë të shpenzimeve për të arritur qëllime specifike të politikave publike; përmbajtjen e akteve dhe procedurave të brendshme dhe informatat për zbatimin e tyre; të ardhurat e udhëheqësve dhe anëtarëve të organeve drejtuese, informata për garancitë dhe ndihmën shtetërore, por edhe për aranzhimet financiare të iniciuara nga vetë ndërmarrjet, përfshirë detyrimet kontraktuese dhe detyrimet që rrjedhin nga partneritetet publiko-private, të gjitha transaksionet materiale me shtetin dhe subjektet e tjera relevante.

▪ PRAKTIKA PO AQ “E MIRË” SA EDHE LIGJI

Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasjen e Lirë në Informata nuk ka mbajtur një evidencë të rregullt për refuzimin e kërkesave dhe ankesave, duke u thirrur në sekret tregtar si bazë për kufizimin e qasjes në informata. Për shembull, në Raportin për Gjendjen e Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe Gjendjen në Fushën e Qasjes në Informata për vitin 2018, të cilin e përgatiti Agjencia dhe i cili në kohën e shkrimit të kësaj analize ishte në procedurë parlamentare, nuk ka asnjë vështrim për efektet e “sekretit tregtar” në qasjen në informata.

10 / “Kjo Direktivë nuk ndikon në: (a) ushtrimin e të drejtës për lirinë e shprehjes dhe informacionit siç është e përcaktuar në Kartë, duke përfshirë respektimin e lirisë dhe pluralizmit të mediave; (b) zbatimin e rregullave të BE-së ose rregullave shtetërore, me të cilat kërkohet nga mbajtësi i një sekretit tregtar të zbulojë informacione, përfshirë sekretet tregtare, trupave të pushtetit publik ose trupave administrative ose gjyqësore me qëllim të ushtrimit të detyrës së këtyre trupave, në interes të publikut.”

11 / OECD Guidelines on Corporate Governance of State-Owned Enterprises, 2015 edition, në dispozicion në: <https://www.oecd.org/corporate/guidelines-corporate-governance-soes.htm> (qasja 26. 5. 2019)

IA, me kërkesë për qasje të lirë në informata, kërkoi qasje në numrin e akteve të organeve të pushtetit të cilave u ishte mohuar qasja në informatë, duke iu referuar pikës 6 të nenit 14 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informata (sekreti tregtar dhe tatimor), sipas organeve të pushtetit që kanë miratuar këto akte, nga fillimi i mbajtjes së evidencës së tillë deri më 4 prill 2019. Mirëpo, kemi marrë vetëm informatën në numër që ka pasur mbi 290 akte të tilla në total, por jo një paraqitje të detajuar sipas organeve konkrete të pushtetit për të përcaktuar shkallën në të cilën ndërmarrjet publike i referohen kësaj dispozite ligjore. Siç është vërejtur tashmë, përmbajtja dhe justifikimi i akteve në të cilat organet e pushtetit i referohen sekretit tregtar, gjithashtu nuk janë analizuar veç e veç.

Megjithatë, vendimet individuale të disponueshme të organeve kompetente konfirmojnë se mungesa e një përkufizimi të sekretit tregtar në Mal të Zi ka ndikim negativ në procedurat administrative dhe kontestet në këtë fushë. Ankesat e trajtuara nga Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasjen e Lirë në Informata, si organ i shkallës së dytë, i referohen çështjeve në të cilat aplikantëve u është refuzuar qasja në informata të tilla, siç janë: kopjet e kontratave të furnizimit me energji elektrike të Elektroekonomisë së Malit të Zi; kopjet e kontratave për marrëveshjen midis Elektroekonomisë së Malit të Zi dhe A2A dhe pagesat bazuar në kontratën për marrëveshjen në fjalë; vendimet e Bordit të Drejtorëve, kopjet e raporteve vjetore të punës dhe kontratat e kredisë së ndërmarrjes “Barska Plovidba”, kopjet e kontratës për bashkëpunim tregtaro-teknik me Kombinatin e Aluminit Podgoricë SHA, të lidhur me Montenegro Bonus dhe Ministrinë e Ekonomisë, kopjet e listave të pagave të punonjësve, kontratat me agjencitë për ndërmjetësim në punësim dhe kontratat për sponsorizim dhe donacione të ndërmarrjes «Plantacionet 13 korriku SHA», kopjet e kartave analitike të ndërmarrjes së Transportit Hekurudhor të Malit të Zi etj.¹² Këto shembuj tregojnë se edhe në përgjigjet e kërkesave, ndërmarrjet i përmbahen formulimeve të gjera të përcaktuara me akte të brendshme, të cilat janë në kundërshtim me Ligjin për Qasje të Lirë në Informata.

Edhe pse shumica e ankesave të përshkruara më lart janë pranuar, qasja në informata të cilat kanë qenë pa arsye të deklaruar si sekret tregtar mbetet e vështirë. Përkatesisht, vendimet e disponueshme të Gjykatës Administrative në proceset e filluara në rastet kur ndërmarrjet publike dhe organet e tjera të pushtetit thirren në sekret tregtar, tregojnë se, edhe kur gjykata vendos drejtë dhe konstaton parregullsi në deklarimin e informatave të caktuara sekret tregtar, drejtësia arrihet ngadalë për shkak të mungesës së vendosjes meritore/përfundimtare në lëndët lidhur me qasjen e lirë në informata.

Për shembull, në lëndën kundër Vendimit të Këshillit për Privatizim dhe Projekte Kapitale, me të cilin u mohua qasja në Kontratën për dhënie me qira afatgjatë të një pjese të pasurisë së NHT «Riviera e Ulqinit» SHA Ulqin lidhur me një kompani private në shtator 2017, Gjykata Administrative konstatoi se ka mangësi në arsyetimin e Vendimit. Në të vërtetë, Këshilli e klasifikoi informatën e kërkuar si sekret tregtar, me sqarim se bëhet fjalë për dokumentacion

12 / <http://www.azlp.me/me/rjesenja-spi>

të tenderit, edhe pse objekti i kërkesës ishte kontrata për qira afatgjatë. Gjykata gjithashtu kujtoi që kufizimet e qasjes në informata janë «restriktive», gjegjë. që vlejné vetëm «nëse zbulimi i informacionit ka të ngjarë të shkaktojë pasoja të dëmshme për interesin i cili është më i rëndësishëm se interesi i publikut për njohjen e kësaj informate».¹³ Mirëpo, ky aktgjykim u dha në shkurt 2019 kundër vendimit të nëntorit 2017 dhe me të lënda kthehet përsëri në rishqyrtim, duke konfirmuar më tej tezën për mbrojtje jo adekuate juridike në këto raste.

Megjithëse Gjykata Administrative i përmbahet, në një farë mase, dispozitave ligjore që përcaktojnë procedurat për kryerjen e një testi të dëmshmërisë kundër zbulimit të informatave të caktuara dhe udhëzojnë në vlerësimin e interesit mbizotërues të publikut, në një seri vendimesh të cilat i referohen informatave të përcaktuara nga Ligji për Shërbimin Doganor si sekret zyrtar (p.sh. deklaratat doganore), e njëjta gjykatë mori qëndrimin se dëmi i shkaktuar nga zbulimi i të dhënave të marra nga autoritetet doganore ishte vlerësuar me dispozitat e atij ligji të veçantë dhe për këtë arsye kryerja e testit të dëmshmërisë është e parëndësishme.¹⁴ Duke marrë parasysh normat e paekzekutuara për sekretin tregtar të Ligjit për Qasje të Lirë në Informata, praktika e tillë relativizon institutin e interesit mbizotërues të publikut dhe detyrimin e kryerjes së testit të dëmshmërisë, çka krahas efektit të ping-pongut (kthimi i lëndëve në rigjykim), pengon qasjen në informata.

ÇKA MË TEJ?

Ndërmarrjet, te të cilat pronar i shumicës së aksioneve është shteti dhe që kryesisht financohen nga buxheti shtetëror kanë detyrime të veçanta për t'u dhënë llogari qytetarëve dhe nuk duhet të barazohen me sektorin privat. Kjo mbështetet nga fakti se standardet ndërkombëtare në këtë fushë formulohen posaçërisht për këto ndërmarrje (OECD) ose që rregulloret e BE-së shprehen qartë se mbrojtja e sekretit tregtar nuk duhet të dëmtojë realizimin e interesit publik dhe detyrimet për informim të publikut.

Sidoqoftë, praktika në Mal të Zi tregon se mungesa e një përkufizimi të vetëm të sekretit tregtar, mungesa e kontrollit mbi përmbajtjen e akteve të brendshme të lëshuara nga ndërmarrjet shtetërore, shoqëruar me mbrojtjen e pamjaftueshme efektive të së drejtës për qasje të lirë në informata dhe ndryshimet diskutabile të Ligjit nga viti 2017, pengon përpjekjet për vlerësim qenësor të vendimmarrjes dhe veprimtarisë së ndërmarrjeve publike.

Në dritën e shembujve praktikë, mund të konkludohet se shumë ndërmarrje konsiderojnë se çdo gjë që «ka të bëjë me biznesin» mund të klasifikohet në mënyrë arbitrare si sekret tregtar. Kjo shkel detyrimet e vendosura ndaj tyre nga ligje të tjera dhe standarde ndërkombëtare. Për më tepër, ndërmarrjet publike e njohin kryesisht pozicionin e tyre si «ndërmarrje» dhe harrojnë për detyrimet që rrjedhin nga të qenit «publik» dhe jo privat.

13 / Aktgjykim i Gjykatës Administrative të Malit të Zi, nr: U 12506/2017, 5. 2. 2019

14 / Aktgjykim i Gjykatës Administrative të Malit të Zi, nr: U 8230/2017, 22. 1. 2019

Përveç përmbajtjes diskutabile të akteve të brendshme për sekretin tregtar, duhet të theksohet se ato zakonisht nuk janë në dispozicion të publikut. Në fillim të hulumtimit tonë, duke kërkuar në internet, ne mundëm të gjenim vetëm tetë dokumente, kryesisht akte të përgjithshme (statute), me anë të të cilave ndërmarrjet publike përcaktojnë në parim sekretin tregtar, kryesisht duke ia lënë përkufizimin më të detajuar akteve të tjera të brendshme që nuk janë botuar në mënyrë proaktive. Kjo është në kundërshtim me standardet e qeverisjes së mirë të ndërmarrjeve në pronësi shtetërore, të zhvilluara nga OECD, e të cilat tregojnë detyrimin për të publikuar në mënyrë proaktive të gjitha aktet dhe procedurat e brendshme. Ky lëshim, në dukje teknik, rezulton me pasiguri ligjore, sepse qytetarët, para fillimit të një procedure ose kontesti të caktuar, nuk mund ta dinë me siguri se çka një ndërmarrje e caktuar konsideron sekret tregtar dhe çka jo, si dhe në çfarë mase është i bazuar vendimi për të shpallur diçka sekret tregtar.

Për më tepër, numërimi taksativ i informatave dhe dokumenteve që përfaqësojnë sekretin tregtar është në kundërshtim me detyrimin e organeve të pushtetit për të kryer testin e dëmshmërisë para se të refuzojnë qasjen në informatë me arsyetimin se është sekret tregtar. Me fjalë të tjera, rregulloret dhe vendimet e ndërmarrjeve publike mbi sekretin tregtar ia humbin kuptimin dispozitës për interesin mbizotërues të publikut dhe detyrimin për të kryer testin e dëmshmërisë, i cili do të duhej të tregojë nëse në rastin e veçantë interesi publik është mbi ndonjë nga kufizimet e përcaktuara për qasje në informatën e kërkuar.

REKOMANDIME:

1.

Qeveria e Malit të Zi, përmes propozimit të ndryshimeve të Ligjit për Shoqëritë Tregtare ose propozimit të një ligji të posaçëm për sekretin tregtar, duhet të përcaktojë qartë se çka nënkuptohet me sekret tregtar, duke vendosur, ndër të tjera, theksin në informatat:

- të cilat kanë **vlerë komerciale**,
- përmbajnë njohuri të pazbuluara, shpikje, arritje (inovacione), **të cilat nuk kanë lindur brenda kornizës së ofrimit të një shërbimi të caktuar publik dhe që nuk kanë të bëjnë me përdorimin e mjeteve financiare nga të ardhurat publike dhe pronës shtetërore;**
- për të cilat **nuk ka asnjë detyrim të publikimit proaktiv në ligje të tjera të veçanta,**
- gjegj. për publikimin e të cilave nuk ka ndonjë **interes mbizotërues të publikut.**

2.

Korniza e përmirësuar ligjore duhet të eliminojë mundësinë që ndërmarrjet, te të cilat shteti është pronar i shumicës së aksioneve, të përcaktojnë me akte të brendshme diskrecionale informatat / dokumentet që mund të shpallen sekret tregtar;

3.

Korniza e përmirësuar ligjore duhet të shfuqizojë përkufizimin “e dyfishtë” të sekretit tregtar si bazë për kufizimin e qasjes në informata, i cili është i pranishëm në Ligjin aktual për Qasje të Lirë në Informata (pikat 5 dhe 6 të nenit 14);

4.

Gjatë hartimit të Ligjit të ri për Qasje të Lirë në Informata, Qeveria e Malit të Zi, Ministria e Administratës Publike dhe Sekretariati për Legjislacion duhet të kryejnë një analizë të hollësishme të standardizimit të sekretit tregtar në ligje të veçanta, të harmonizojnë përkufizimet e sekretit tregtar në një mënyrë që nuk do të bie në kundërshtim me detyrimet e transparencës proaktive të mbajtësve të autorizimeve publike gjegj. të organeve të pushtetit, në kuptim të Ligjit për Qasje të Lirë në Informata;

5.

Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasjen e Lirë në Informata duhet të bëjë monitorim inspektues të publikimit proaktiv të informatave nga ndërmarrjet të cilat shteti është pronar i shumicës së aksioneve dhe të raportojë në mënyrë proaktive e të saktë për respektimin e dispozitave të Ligjit për Qasje të Lirë në Informata nga ndërmarrjet publike dhe organet e tjera të pushtetit;

6.

Bazuar në mbikëqyrjen e kryer të inspektimit, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasje e Lirë në Informata duhet të përdorë mundësinë ligjore për të filluar procedurat për përcaktimin e përgjegjësisë kundërvajtëse në ndërmarrjet që nuk respektojnë detyrimet e publikimit proaktiv të informatave.

BURIMET:

- Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasje të Lirë në Informata, **Raporti për Gjendjen e Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe Gjendjen në Fushën e Qasjes në Informata për vitin 2018**, Podgoricë, mars 2019, në dispozicion në: <http://skupstina.me/index.php/me/sjednice/zakoni-i-drugi-akti>;
- Direktiva (BE) 2016/943 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e 8 qershorit 2016 për mbrojtjen e dijeve dhe përvojave të pazbuluara, si dhe të informatave të biznesit (sekretit tregtar) nga prokurimi, përdorimi dhe zbulimi i paligjshëm, **Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian**, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/HR/TXT/?uri=CELEX%3A32016L0943>;
- Aktet interne të ndërmarrjeve në vijim: NP Parqet Nacionale të Malit të Zi, NP Ujësjellësi Rajonal Bregdeti i Malit të Zi, NP për Menaxhimin e të Mirave Detare të Malit të Zi, Elektroekonomia e Malit të Zi SHA Nikshiq, Monteput SHPK Podgoricë, Porti i Tivarit SHA Tivar, N.H.T. Riviera e Ulqinit Ulqin, Instituti i Metalurgjisë së Zezë SHA Nikshiq, "Barska plovdba" SHA Tivar, SHPPK Qendra për Testime Ekotoksikologjike, Sistemi i Transmetimit të Energjisë i Malit të Zi, Posta e Malit të Zi SHA Podgoricë, Mirëmbajtja e Mjeteve Hekurudhore, SHPK Operatori i Tregut të Energjisë Elektrike i Malit të Zi, Montenegro Bonus SHPK Cetinë, Infrastruktura Hekurudhore e Malit të Zi SHA Podgoricë, Plantacionet "13 Korriku" SHA Podgoricë;
- Rrjeti për Afirmimin e Sektorit Joqeveritar, **Shumica e ndërmarrjeve publike në Mal të Zi nuk publikojnë në mënyrë proaktive as gjysmën e informatave**, 19.11.2018, në dispozicion në: <http://www.mans.co.me/vecina-javnih-preduzeca-u-crnoj-gori-proaktivno-ne-objavljuje-ni-polovinu-informacija/>
- OECD Guidelines on Corporate Governance of State-Owned Enterprises, 2015 edition, në dispozicion në: <https://www.oecd.org/corporate/guidelines-corporate-governance-soes.htm>;
- Aktgjykimi i Gjykatës Administrative të Malit të Zi, nr: U 12506/2017, 5. 2. 2019;
- Aktgjykimi i Gjykatës Administrative të Malit të Zi, nr: U 8230/2017, 22. 1. 2019;
- Vendimet e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasje të Lirë në Informata, <http://www.azlp.me/me/rjesenja-spi>;
- Ligji për Qasje të Lirë në Informata, ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 044/12 datë 09.08.2012, 030/17 datë 09.05.2017).

- SHTOJCË 1: STANDARDIZIMI I SEKRETIT TREGTAR NË LIGJE TË VEÇANTA

Ligji për Shërbimin Doganor

"Të dhënat individuale për personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në deklaratat doganore, si dhe të dhënat e nevojshme për përcaktimin dhe verifikimin e vlerës doganore të mallrave, në përputhje me dispozitat e ligjit që rregullon punët doganore dhe dispozitat e ligjit që rregullon statistikën zyrtare dhe sistemin e statistikave zyrtare, konsiderohen sekret zyrtar dhe nuk mund të zbulohen nga autoriteti doganor pa pëlqimin eksplicit të personit ose autoriteteve kompetente që i kanë dhënë. "

Ligji për Prokurimet Publike

"Të dhëna të fshehta (sekrete) janë të gjitha informatat ose materialet, pavarësisht nga forma, natyra apo mënyra e tyre e transmetimit, të cilat janë të shënuara me shkallë fshehtësie në përputhje me normat që rregullojnë fshehtësinë e të dhënave, zbulimi i të cilave një personi të paautorizuar do të shkaktojë ose mund të shkaktojë pasojë të dëmshme për sigurinë dhe mbrojtjen, politikën e jashtme, monetare dhe ekonomike të Malit të Zi; Porositësi është i detyruar: të mbajë si të dhëna sekrete të dhënat e përfshira në ofertë, të cilat në përputhje me ligjin janë të përcaktuara si të fshehta dhe të cilat ofertuesi i ka shënuar si të fshehta në ofertë; të refuzojë dhënien e informatave që mund të shkelin fshehtësinë e të dhënave të cekura në ofertë. Çmimi dhe të dhënat e tjera nga oferta me rëndësi për vlerësimin e rregullsisë dhe të vlerësimit të ofertës nuk konsiderohen sekrete. Porositësi mund të kërkojë mbrojtjen e fshehtësisë së të dhënave të vëna në dispozicion të ofertuesve me dokumentacion të tenderit. (...) Nëse një pjesë e dokumentacionit të tenderit përmban të dhëna të fshehta, porositësi në pjesën e dokumentacionit të tenderit që ai publikon do të cekë mënyrën se si personat e interesuar mund të marrin një pjesë të dokumentacionit të tenderit që përmban të dhëna të fshehta në përputhje me normat që rregullojnë fshehtësinë e të dhënave. "

Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve

"Përfaqësuesi është i detyruar të ruajë sekretet tregtare të porositetit (klientit) të tij, të cilat i ka mësuar në raport me punën e besuar. Përfaqësuesi është përgjegjës nëse i përdor ato ose i zbulon ato pas përfundimit të kontratës për përfaqësim tregtar. "

Ligji për Shoqëritë Tregtare

"Anëtarët e bordit të drejtorëve janë të detyruar të mbajnë sekretet tregtare të shoqërive. (...) Revizori është përgjegjës për keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit të tij, veçanërisht nëse ai kontribuon me dashje ose nga pakujdesia në veprimtari mashtruese të menaxherit ose publikon në mënyrë të paligjshme ose i zbulon personave të paautorizuar sekretet tregtare të klientit ose në mënyrë tjetër kontribuon në dëmin e shoqërisë dhe mund të paditet për kompensimin e dëmit së bashku me anëtarët e bordit të drejtorëve dhe drejtorin gjeneral; (...) Lejohet kopjimi i dokumentacionit të cilin mund ta shikojë një aksionar nëse nuk paraqet sekret tregtar të shoqërisë "

Kryetari i Këshillit, anëtarë i Këshillit, drejtori i Agjencisë, Zëvendës Drejtori i Agjencisë, Ndihmësi Drejtori i Agjencisë dhe punonjësit e Agjencisë janë të obliguar që si sekret, në përputhje me dispozitat që rregullojnë fshehtësinë e të dhënave, të ruajnë të gjitha të dhënat që ata zbulojnë në kryerjen e punëve dhe detyrave në përputhje me këtë Ligj (...) Agjencia vendos pa mbajtur seancë gojore, përveç nëse, me kërkesën e arsyeshme të palës ose sipas vlerësimit të saj gjatë procedurës, përcakton se është e nevojshme mbajtja e një seance të tillë. Në procedurat para Agjencisë në të cilat zhvillohet seanca gojore, me qëllim të mbrojtjes së sekretit zyrtar dhe tregtar, nuk ka publik. Me sekret tregtar nënkuptohen në veçanti informatat tregtare që kanë vlerë të vërtetë ose të mundshme të tregut dhe zbulimi ose përdorimi i të cilave mund të rezultojë në avantazh ekonomik për pjesëmarrësit e tjerë të tregut. (...) Me kërkesë të Agjencisë, organet shtetërore, organet e administratës shtetërore, organet e qeverisjes vendore, organet e vetëqeverisjes vendore dhe personat e tjerë juridikë që ushtrojnë kompetenca publike janë të detyruar të japin, pa kompensim, të gjitha të dhënat e nevojshme për procesin e vendimmarrjes së Agjencisë, në përputhje me këtë Ligj, përfshirë të dhënat të cilat mund të paraqesin sekret tregtar, si dhe të dhënat e tjera konfidenciale, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. "

Neni 171

- Neni 280

- Neni 368

Ligji për Bankat

“Sekret bankar konsiderohen: të dhënat mbi pronarët dhe numrat e llogarive të hapura në bankë; të dhëna për gjendjen individuale të depozitave individuale dhe qarkullimin në llogaritë individuale të personave juridikë dhe fizikë të hapur në bankë; të dhëna të tjera të klientit të marra nga banka në bazë të ofrimit të shërbimeve për klientin e bankës. Sekret bankar është sekret tregtar. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve, aksionarët, të gjithë punonjësit e bankës dhe personat e tjerë që gjatë kryerjes të punëve me bankën ose për bankën bien në posedim të informatave dhe të dhënave të përcaktuara si sekret bankar me këtë ligj, janë të detyruar që gjatë punës së tyre në bankë dhe pas përfundimit të punës në bankë, të ruajnë këto të dhëna dhe informata dhe nuk guxojnë t'i përdorin ato për përfitimin e tyre personal e as t'i vënë në dispozicion të personave të tjerë. Përgjatë kësaj (...) të dhënat që janë sekret bankar mund të vihen në dispozicion të: Bankës Qendrore; autoritetit gjyqësor kompetent; personave të tjerë, ndërsa me pëlqimin e shprehur me shkrim të klientit, organit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me ligjin që rregullon parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit; Fondit për Mbrojtjen e Depozitave mund t'i vihen në dispozicion të dhënat në përputhje me ligjin që rregullon mbrojtjen e depozitave; e dhëna mbi numrin e llogarisë së personit juridik dhe personit fizik i cili ushtron një veprimtari të regjistruar mund t'i vihet në dispozicion organit tatimor, si dhe kreditorit të klientit të bankës, i cili paraqet në bankë një vendim gjyqësor përmbarimi ose një dokument tjetër përmbarimi të vendosur me ligj; të dhënat mbi bonitetin dhe kredinë e klientit të ajo bankë mund t'i vihen në dispozicion një banke tjetër ose një anëtar i një grupi bankar për qëllime të menaxhimit të rrezikut të kredisë; të dhënat për borxhin e kredisë së klientit në atë bankë dhe rregullsinë në shlyerjen e kredisë së aprovuar mund të vihen në dispozicion të personave që, në bazë të një kredie të tillë, kanë një detyrim të mundshëm ndaj bankës, si zhirantë, garantes dhe të ngjashme.

Instituti alternativa (IA) është një shoqatë joqeveritare e themeluar në shtator të vitit 2007 nga një grup qytetarësh me përvojë në shoqërinë civile, administratën publike dhe sektorin e biznesit.

Misioni ynë është të forcojmë proceset demokratike dhe qeverisjen e mirë në Mal të Zi duke hulumtuar dhe analizuar opsionet e politikave publike, si dhe monitorimin e punës së administratës publike.

Qëllimet tona strategjike janë të ngremë cilësinë e punës, përgjegjshmërinë, transparencën dhe efikasitetin e administratës publike; nxitjen e debateve të hapura, publike, konstruktive dhe të argumentuara për politikatat publike dhe forcimin e aftësive të shtetit dhe shoqërisë për zhvillimin e tyre.

Vlerat që ne ndjekim në punën tonë janë angazhimi për mision, pavarësi, mësim të vazhdueshëm, rrjetëzim, bashkëpunim dhe punë në grup.

Ne veprojmë si qendër **think tank**, gjegjësisht, qendër kërkimore dhe në punën tonë adresojmë fushat e qeverisjes së mirë, transparencës dhe përgjegjshmërisë. Fushat në të cilat ne punojmë dhe ushtrojmë ndikim janë të strukturuar në pesë programe kryesore: administratën publike, financat publike të përgjegjshme, siguri dhe mbrojtje dhe politikën sociale.

Bazuar në punën në pesë programet tona, ne jemi të angazhuar në monitorimin e procesit të negociatave të anëtarësimit në BE, me pjesëmarrje aktive në grupet e punës për Kapitujt: Prokurimi Publik (5), Drejtësia dhe të Drejtat Themelore (23) dhe Mbikëqyrja Financiare (32). Aktiviteti ynë i veçantë është Shkolla e Politikave Publike, të cilën ne kemi organizuar që nga viti 2012, kurse në vitin 2018 e kemi organizuar Shkollën tonë të parë për Buxhet të Hapur.

Në punën tonë deri tani, ne kemi bashkëpunuar në mënyrë aktive me mbi 40 organizata në rrjetet rajonale të Ballkanit Perëndimor dhe me mbi 100 organizata në Mal të Zi. Instituti është i përfshirë në mënyrë aktive në rrjetet rajonale: Think for Europe (TEN), Pointpulse, SELDI, WeBER, Koalicioni UNCAC, Global BTAP, PASOS dhe Koalicionin për mbrojtjen e informatorëve të Evropës Juglindore.

Rezultatet e punës sonë janë përmbledhur në 107 publikime, raporte dhe analiza, kurse vendimmarrësve iu kemi dërguar më shumë se 1000 rekomandime. Mbi katër mijë herë kemi paraqitur propozime dhe rekomandime në media për politika më të mira publike.

Ne kemi hapur edhe tre faqe interneti. **"Qyteti im"** është një përpjekje fillestare për të paraqitur të dhënat e buxhetit për qeveritë lokale. Pas tij, u krijua **"Administrata ime"**, një adresë për qytetarët që duan të raportojnë një problem me të cilin hasën kur ushtrojnë të drejtat e tyre në administratën publike. Portali më i fundit në internet **"Paraja ime"** është rezultat i synimit tonë për të bërë të disponueshme mijëra të dhëna jo të kërkueshme, apo "të bllokuara".

Instituti Alternativa rregullisht publikon informata për financat, projektet dhe donatorët që kanë mbështetur punën e organizatës. Për këtë arsye, Instituti, për të tretin vit me radhë ka fituar pesë yje për transparencën, nga një studim i kryer nga organizata ndërkombëtare jofitimprurëse Transparify, e cila vlerëson transparencën e mbi 200 qendrave kërkimore.

Bordi i Drejtorëve i IA kryesohet nga Stevo Muk, dhe organizata jonë aktualisht përbëhet nga një ekip prej dhjetë anëtarësh.